



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

PROCESVERBAL

Nr. 5, datë 11.06.2025

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 14:15

Data e mbajtjes së mbledhjes : 11.06.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar këshilltarë ! I nderuar zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës.

Në këtë mbledhje, siç jeni vënë në dijeni dhe nëpërmjet email-it të dërguar nga sekretaria, do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë dhe nga Komisioni i Mandateve. Ftoj sekretaren të bëj apelin.

Dorina Milja: Përshëndetje ! Fillojmë...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

37 Këshilltarë në sallë. *(Gjatë zhvillimit të mbledhjes nga salla largohen 3 këshilltarë)*

Denisa Luarasi: : Faleminderit Dori.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen. Sot në rend të ditës kemi 12 pika.

Po kaloj në leximin e tyre.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN PËRFUNDIMTAR TË PRONËS, ME EMËRTIMIN “VARREZA”, BASHKIA DURRËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN PËRFUNDIMTAR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TEK BASHKIA DURRËS, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ
Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN PËRFUNDIMTAR TË PRONËS, ME EMËRTIMIN “VARREZA”, BASHKIA DURRËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE KATUNDI RI
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK PËRSA I PËRKET LISTAVE TË PËRFITUESVE, BANORË NË BANESAT INDIVIDUALE, TË CILËT KANË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT TË ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE DURRËS, SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 164, DATË 19.2.2020, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK TË LISTËS SË PËRFITUESVE, BANORË NË PALLATET E DËMTUARA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE SUKTH, KATUND I RI SI DHE NJËSITË ADMINISTRATIVE NR.3 DHE NR.4, BASHKIA DURRËS, TË CILËT KANË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT TË ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 164, DATË 19.2.2020, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”.
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT NR. 30, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.1032, RRUGA “ALEKS KOMNENI” DHE PALLATIN “KASTRATI”, RRUGA “RAMADAN VELIU”, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019” TË NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET MIRATIMIT TË SIPËRFAQEVE SHITESË
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË SHPËRNDARJES SË SUBVENCIONIMIT PËR OPERATORËT E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK QYTETAS NË BASHKINË DURRËS

Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA KU DO TË USHTROHET VEPRIMTARIA SI STACION PLAZHI, PLAZHET PUBLIKE PËR VITIN 2025, SI DHE PLOTËSIMIN E SAJ ME ELEMENTËT E NEVOJSHËM LIDHUR ME STANDARTET E KËRKUARA NGA AKTET LIGJORE NË FUQI.
Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT Z.ANI DYRMISHI
Pika 10. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARES Z.NJ.MANJOLA LUKU
Pika 11. Shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NDRYSHIMIN E PIKËS 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.166, DATË 03.11.2023 “PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT ARTISTIK PRANË QENDRËS KULTURORE “ALEKSANDËR MOISIU”
Pika 12. shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NDRYSHIMIN E PIKËS 1, TË VKB-SË NR.11, DATË 30.04.2025 “PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VAZHDIMIN E PROCEDURËS SË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË PËRDORIMIT TË SIPËRFAQES PYJORE NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR, NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.37, DATË 01.08.2023 TË KKT-SË “PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN RESORT TURISTIK LURA 5, FAZA 3, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA Durrës”, PËR SHKAK TË NJË GABIMI MATERIAL

Faleminderit.

Keni ndonjë koment?

Atëherë komente nuk ka. E hedhim në votim.

Kush është dakort?

Po z. Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Nuk është koment, por duke pasur parasysh këto pikat, pika 11, 12 siç janë shtesë për mua janë dhe pika që ne mund t'i kalojmë shpejt për arsye që e dyta është për një korrigjim, ajo tjetra është vetëm për një ndërrim emri dhe vazhdojmë normalisht me pikat, të cilat pastaj kanë zhvillim normal të mbledhjes.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit për sqarimin.

Rolant Xhelilaj: Në qoftë se janë dakort

Denisa Luarasi: Atëhere e hedhim në votim.

Kush është pro rendit të ditës?

Kundra?

Abstenim?S'ka

37 vota pro miratohet pa ndryshime

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 1**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Përsëndetje Kryetare! Përsëndetje të gjithë!

Atëherë në lidhje me pikën e parë, komisioni u mbledh dhe miratoi me shumicën e votave kështu që propozojmë sot që këshilli ta miratojë pikën 1. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj. E merr fjalën Komisioni i Pronave Publike, Transporti Trafikut Rrugor, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola:Faleminderit kryetare.

Atëherë Komisioni i Pronave Publike u mbledh dhe me votë unanime e kalon për votim në këshillin bashkiak.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zoti Markola.

Komente, pyetje ka?

E hedhim votim.

Kush është pro?

Kundër ?.....

Abstenim ?....

Okej, faleminderit.

Kundër, abstenim s'ka.

37 pro miratohet pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 2**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Dhe për pikën e dytë komisioni vendosi me shumicë votash për ta miratuar dhe propozojmë sot në këshill bashkiak. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Pronave Publike, Transportit Trafikut Rrugor, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Edhe pikën 2 në unanimitet komisioni e kalon për votim në këshillin bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

Komente kemi? Nuk ka.

Kalojmë votim për pikën 2 të rendit të ditës.

Kush është pro?

Kundër?.....

Abstenim?....

Atëherë 37 pro. Kundra, abstenim s'ka. Rezultati 37. Miratohet pa ndryshime projektvendimi i pikës 2.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 3**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Musaraj.

Joniada Musaraj: Po kryetare dhe pikën 3 komisioni ynë e miratoi me shumicë votash dhe propozojmë sot të kalojë në këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Pronave Publike, Transportit Trafikut Rrugor zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Po edhe pika 3 kalon në unanimitet për votim në këshillin bashkiak.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zoti Markola.

Komente, pyetje kemi?

E hedhim votim pikën 3 të rendit ditës?

Kush është pro?

Atëherë me 37 pro miratohet dhe pika e 3-të e rendit të ditës.

- **Për pikën 4** të rendit të ditës e kërkon fjalën nënkryetari i bashkisë.

Gentian Kallmi: Përshëndetje të gjithëve.

Në lidhje me pikën 4 dhe rrjedhimisht më pas me pikën 5 të rendit ditës doja t'ju kërkoja në interesin qytetar duke vlerësuar shqetësimet e të shumta të qytetarëve, komisionit përkatës, por dhe këshillit për vendimmarrje në qoftë se e shohin të arsyeshme për rivlerësimin e situatës së banorëve kryesisht besoj për vendbanimet në një qytet tjetër ose për aplikimet, duke qenë se për pallatet që janë rindërtuar në të njëjtin vend nuk ka aplikim, nuk është kërkuar aplikim, ndërkohë që legjislacioni kërkon aplikim. Kemi shtëpia individuale në të njëjtën llogjikë pa aplikim, por me dosje dhe me vërtetim, me dokumentacion të vërtetuar të banesave të dëmtuara nga tërmeti. Ky është një sugjerim për vendimmarrjen ju takon juve. Ne propozimin tonë e kemi shprehur në relacionin dhe projektvendimin.

Ardian Muka : Kush ishte sugjerimi?

Gentian Kallmi: Sugjerimi është që këshilli duke qenë se është një pikë goxha sensitive të rivlerësojë këto dy argumente duke qenë se edhe legjislacioni përkatës nuk e shpreh shprehimisht. Ne i qëndrojmë strikt legjislacionit, por mund të ketë nevojë për interpretim nga ana e këshillit.

Dritan Burgjia : Ta kalojmë apo ta rivlerësojmë?

Gentian Kallmi: Jo, ta rivlerësojmë.

Denisa Luarasi: Faleminderit. Zoti nënkryetar.

E ka kërkuar fjalën zonja Kasa.

Flutura Kasa: Atëherë... si?

Denisa Luarasi: Flutra, Flutra t'ia japim fjalën komisionit pastaj kalojmë te komentet. Ok?
Jepet fjala për projektvendimin e **pikës 4**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Unë sot si kryetare e komisionit i drejtohem Këshillit Bashkiak në frymën dhe të propozimit të nënkryetarit dhe jam e lumtur për këtë gjë, sepse dhe në komision në fakt kur janë diskutuar dhe në mbledhjen e kaluar kjo çështje ka patur edhe diskutime dhe mendime janë dhënë. Unë do t'i kërkoja këshillit sot, do t'i propozoja dhe në fakt doja dhe që të merrte miratimin e të gjithë anëtarëve të Këshillit prezent sot, që të merret parasysh propozimi i nënkryetarit të bashkisë që të kualifikohen, të kenë statusin e të kualifikuarit sërish personat që mund të mos kenë aplikim ose që mund të kenë vendbanim diku tjetër. Ndoshta mund të shtohet si një kriter, mund të pranohet si kriter që mund të sjellin një vërtetim hipotekor, që nuk ka një banesë të dytë aty ku figuroj në qytetin tjetër si banor. Kështu që propozoj sot këshillit që ta marrim parasysh kërkesën si kryetare e komisionit dhe si anëtare e këshillit për sa kohë të gjithë bashkë kemi një qëllim të përbashkët që vendimmarrja jonë në fund të ditës kur të ketë efekt dhe pasojat tek qytetarët të jenë pasoja të mira t'i mirëkuptojmë qytetarët shqetësimin e tyre dhe kjo është e gjitha. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Musaraj.

Jonuz Myshketa: Mundem?

Denisa Luarasi: Atëherë, jo te flasi dhe komisioni pastaj tek komentet ju lutem.
Po po Komisioni i Strehimit dhe i Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Përshëndetje.

Në vijimësi dhe vazhdimësi të fjalës së zëvendëskryetarit të bashkisë dhe kryetares së Komisionit për Çështjet Juridike, jam dakort dhe si komision propozojmë duke qenë se institucionet e qeverisjes vendore, Bashkia si një nga institucionet kryesore të qeverisjes vendore duhet të jetë sa më afër qytetarit, sa më afër interesave të qytetarëve, dhe duke qenë se këto dy çështje prekin drejtpërdrejt interesat më të larta të tyre siç është prona, ta rivlerësojmë dhe njëherë si këshill dhe propozoj ta miratojmë të gjithë unanimisht vlerësimin e këtyre dy pikave edhe njëherë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit Zonja Feshti.
E ka kërkuar fjalën zonja Kasa.

Flutura Kasa : Atëhere unë,

Denisa Luarasi: Ju lutem ta dëgjojmë zonjën Kasa.

Flutura Kasa: A mundet pak?

Denisa Luarasi: Ju lutem pak qetësi.

Flutura Kasa: Atëherë unë e falenderoj personalisht nënkryetarin e bashkisë dhe mbështetjen e dy kryetarëve të komisioneve përkatëse, sepse unë kur të fillonin këto dy pika do e deklaroja votën kundër, por meqënëse u bë një propozim i tillë atëherë unë tërhiqem dhe bashkohem me parafolësit. Kaq.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Kasa.
Zoti Muka.

Ardian Muka: Më fal për të qenë më të më të saktë me veten me këshilltarët edhe me opinionin, po propozoni që ta rrëzojmë këtë, pra pikën katër dhe pikën pesë. Kur flisni për reflektim, çfarë domethënë reflektim? Aty përjashtohen banorë nga e drejta e marrjes së apartamenteve nga procesi i rindërtimit. Propozimi juaj është që neve ta rrëzojmë si këshill meqënëse kjo ka ardhur me ndryshim dhe të lejë fuqi aktin që neve kemi marrë në vendimin e këshillit datës. Ajo siç është aktualisht. Këtë po propozoni? Reflektimi, çfarë domethënë reflektim?

Gentian Kallmi: Atëherë ju keni një relacion dhe një projekt vendim të propozuar nga institucioni i bashkisë, duke qenë se është mjaft sensitive dhe me interes të lartë duke vlerësuar shqetësimet e qytetarëve, ne i qëndrojmë propozimit tonë relacionit dhe projektvendimit, por duke qenë se ka hapësirë për t'u diskutuar, unë ftoj në rivlerësim këshillin, i cili mund ta miratojë siç është, mund ta miratojë me ndryshime. Është një vendim që i përket këshillit.

Ardian Muka: Me thënë të drejtën doja të komplimentoja pjesën e bashkisë dhe të kolegëve të opozitës, por ngelet diçka prapë me mexitermini. Domethënë ngel diçka që nuk është as mish as peshk. Në qoftë se ju vini me një propozim dhe thoni do përjashtohen dhe propozimi është të përjashtohen nga relacioni, atëhere neve duhet ta hedhim poshtë dhe bëjmë një propozim kur të vijë një propozim tjetër ose momentin që ne hedhim poshtë ngel në fuqi ajo siç është edhe të gjithë ato banorë përfitojnë atë ç'kanë për të përfituar.

Thashë doja t'ju komplimentoja por nuk nuk më vjen e plotë dhe pjesa e komplementit, është diçka që neve e kemi ngritur edhe në mbledhje e mëpërparshme dhe na vjen mirë që pjesa e opozitës ka reflektuar për atë çfarë ne kemi thënë. Natyrisht ajo çfarë është, ka të bëjë me ndjeshmërinë e qytetarëve. Flasim për pronën dhe neve diskutuam këtu në këtë këshill që nuk është e drejtë për dikë që ka dhe një apartament tjetër, por që mund të ketë tre fëmijë mos të përfitojë atë çfarë ai ka i takon me të drejtë duke paguar taksat pranë bashkisë, pranë institucioneve. Sikurse dhe ato që banojnë në qytete të tjera, por që janë transferuar në Durrës. Atje shtëpia mund të jetë nuk e dimë në çfarë gjendje, por përderisa janë banorë të Durrësit, paguajnë taksat në Durrës, nuk ka pse mos të përfitojnë. Meqënëse them është shpallur situata e emergjencave civile, automatikisht me procesin e rindërtimit të gjithë këtyre banorëve i takonte e drejta që të përfitohen apartamentet. Në këtë dritë unë do thoja që dhe vendimi që ne kemi marrë, vendimi i kaluar duhet të rishihet. Pra për objektet që kemi ke objekti që kemi te pallati Kastrati dhe objekti tjetër që është tek Ujësjellësi, pra dy godinat të cilat ky këshill mori një vendim kundra, pra që t'i përjashtonte nga e drejta e përfitimit të atyre banorëve dhe ai vendim në këtë frymë duhet të rishihet, sepse në qoftë se këtyre do t'i japim të drejtën të gëzojnë pronën, pse jo atyre të tjerëve mos t'i takojë kjo e drejtë. Megjithatë thashë jam akoma, unë jam për shpreh votën kundra siç është momentalisht i ndërtuar ky projektvendim që na keni sjellë, duke votuar kështu ju lemë juve mundësinë që ta rikorrigjoni

dhe të na sjellni një vendim siç duhet kur ose të leni fuqi atë që është pra vendimi që është në fuqi këto automatikisht e përfitojnë. Faleminderit.

Dritan Burgjia: Mikrofonin të lutem...

Tani këto dy pika prodhojnë efekt, meqë u fol këtu domethënë për shqetësime qytetare dhe për ndjeshmëri qytetare. Këto prodhojnë efekt. Nëse ne i miratojmë edhe me ato ndryshime që ju thoni ju këto qytetarë janë të shkruaj te këto dy pika që ne miratojmë sot. Kështu që propozimi im është që të paktën këto 2 pika të shtyhen, të rikompozohen dhe pastaj t'i miratojmë në një mbledhje tjetër. Domethënë ne ishim të përgatitur për t'i kundërshtuar këto dy pika pikërisht për këtë sepse përjashtohen qytetarë nga skema e rindërtimit. Mbas gjashtë vjetësh, mbasi këto qytetarë domethënë i kanë kaluar filtrat e bashkisë edhe të institucioneve të tjera, më falni, vjen sot mbas gjashtë vjetësh ne i përjashtojmë dot këto nga skema e rindërtimit dhe këtu marshkas i drejtohem mediave, i drejtohem qytetarëve nëpërmjet mediave që t'i drejtohen Partisë Demokratike, të na drejtohen ne si këshilltarë të shprehin shqetësimet, sepse ne nuk na është bërë prezent mbi relacionin që ne kemi përpara. Ne nuk shqyrtojmë dot pse janë përjashtuar, domethënë është shumë i vakët shpjegimi, kështu që i drejtohem qytetarëve të drejtohen tek ne për të na shpjeguar dhe problematikën që ata kanë. Kështu që propozimi është ta shtyjmë të paktën t'i shtyjmë këto dy pika.

Flutura Kasa: Ishe shumë mirë deri tashi. Po leje politikën o burrë. Leje. Ishe shumë mirë për t'u shty dy pikat. Po ajo është hall shtëpie, ti thu partia.

Denisa Luarasi: Flutra të lutem....

Jo, e merr fjalën zoti nënkryetar, ju lutem.

Gentian Kallmi: Në përgjigje të komentit tuaj, sugjerimet për rivlerësim nuk i përket në total vendimit, projektvendimit edhe vendimmarrjes nga ana juaj. Për arsyet e vendbanimit në një qytet tjetër dhe mungesës së aplikimit, sugjerimi ishte për t'u rivlerësuar, jo sugjerim për ta votuar kundër ose pro, për ta rivlerësuar ju si këshill. Nga ana tjetër besoj unë personalisht po besoj institucioni ynë edhe këshilli që jemi në fazat e fundit të dhënies së apartamenteve dhe shtyrja thjesht do t'i shtyjë. Në qoftë se nuk e di proceduralisht mund të votohet me ndryshime. Në qoftë se do votohet me ndryshime ju takon juve, shtyrja thjesht do t'i shtyjë akoma hyrjen në shtëpi, në shtëpitë e reja. Këtë merak kam unë personalisht.

Joniada Musaraj: E pati fjalën kolegu e mori prapë, e kam ndezur mikrofonin. Atëherë të sqaroj ja vetëm një sekond që të jenë të qartë të gjithë këshilltarët. Procedura që ne propozojmë është kjo që kur çelet votimi nga kryetarja sot të miratohen propozimet që solla unë si kryetare e komisionit që do të thotë të miratohet pika katër dhe pesë me ndryshimet që propozohen nga ne si dy komisione, që do të thotë siç tha nënkryetari në thelb në tërësinë e tij pika e tyre pika katër dhe pesë nuk ndryshon, sepse normalisht mbeten po prapë të përjashtuar ata persona që kanë banesë të dytë prandaj nuk e marrim në tërësi ta rrëzojmë pikën katër dhe pesë, por propozoj që të çelet sot votimi dhe të mos ketë shtyrje për pikën katër dhe pesë në lidhje me propozimet që unë thashë sot dhe kolegja Feshti. Për mua është e tepërt shtyrja e kohës se ne prandaj e bëjmë dhe këtë reflektimin që t'i japim zgjidhje çështjeve sa më shpejt dhe të reflektojmë sa më shpejt. Kjo është e gjitha. Pra kryetare të lutem të jenë të qartë në lidhje me votimin. Çfarë do të thotë

çelje e votimit sot që doja nga ana juaj që të hidhni për votim propozimet që unë solla si kryetare e komisionit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.
Fjalën e ka Joni Myshketa.

Jonuz Myshketa: Atëherë përshëndetje të nderuar kolegë.

Dhe unë do t'i shkoj linjës së dy së kolegëve parafolës. Pra më vjen mirë që pas mbledhjes së fundit ku pati debat në lidhje me pallatin Kastrati ose tek Ujësjells si u diskutua, të cilët u mor një vendim për përjashtimin kur që në gjykimin tim thirrja që për të gjithë kolegët tonë këtu që të shikonim anën njerëzore dhe nuk kishte asnjë lloj arsyeje përjashtimi. Për më tepër, duke pasur parasysh që ka dhe një nen, neni 21, neni 9 pika 21, ku thuhet për objektet të cilët janë dëmtuar nga fatkeqësi natyrore si gjen e jashtëzakonshme e tërmetit dhe kur rindërtohen në po të njëjtin vend, të gjithë banorët që kanë pasur banesë aty do marrin po aq sa i takon, por aq sa kanë pasur, jo më tepër. Dhe në vazhden e pikës katërt dhe pikës pesë, po unë jam dakort që të ndryshohet dhe të gjithë ata banorë, të cilët për shkak të mosaplikimit, se mund të jetë dhe raste njerëzore, të rikualifikohen dhe të bëhet aplikimi të shtyhet, sepse humbin banesat nëse nuk munden dhe nëse mund të kenë banesë tjetër se ne e dimë shumë mirë që për shkak të gjithë sistemit që ka ndryshuar 35 vite dikush ka banesë në Durrës kur kryen gjithë aktivitetin e tij jetësor, por mund të ketë dhe një banesë në po të them diku në Golem dhe meqë e ka këtë nuk mund të përfitojë aty ku zhvillon jetën. Pra unë jam dakort që për pikat katër dhe pesë t'i votojë pro parimisht nëse rifuten të gjithë në vazhden e marrjes së asaj që takon. Por duhet të rifutet dhe të gjithë banorët, të cilët janë përjashtuar me një ndryshim të VKB-së të Vendimit të Këshill Bashkiak 2021 në pallatin Kastrati, sepse dhe Akti Normativ numër 9, neni 21 e thotë qartë që ata në gjykimin tim janë përjashtuar me të padrejtë. Pra jam dakort me atë ç'ka thatë ju. Më vjen mirë për reflektimi dhe njëherë por duhet që të gjithë banorët të marrin ata që i takon, sepse janë frut i punës së ndershme të tyre. Shumë faleminderit zoti Myshketa.

Denisa Luarasi: Faleminderit z. Myshketa.
T'ia japim fjalën Z. Burgija.

Rolant Xhelilaj: Në qoftë se do flasësh në emër të grupit vazhdo.

Denisa Luarasi: T'ia japim fjalën zotit Burgija në fund kryetar, sepse dhe e kërkoj.

Dritan Burgija: Po shiko këtu kur themi jeni të paqartë jeni të paqartë. Këtu kemi rast që keni përjashtuar për mos aplikim. për mos aplikim. Domethënë ne atëherë që t'i bëmë shkurt, ne po ju themi që bëmë dakort me ndryshimet që ju kërkon, por nuk bëmë dakort me përjashtimet që i bëni këtyre banorëve. Tani si do t'i ndajmë këto punë? Si do ta votojmë këtë? T'ju votojmë ndryshimet dhe pastaj pikat t'i miratojmë, t'i votojmë kundër. E kemi të pamundur ta bëjmë këtë pjesë. Kështu që rishqyrtojeni dhe këto emra, na i veni në dispozicion prapë, të miratojmë sot vetëm ndryshimet dhe na vini prapë me relacion tjetër mbledhjen e ardhshme, se në të kundërt ne duhet t'i votojmë kundër katrën dhe pesën, pikat katër dhe pesë duke qenë dakort me propozimet tuaja.

Ardian Muka: Meqënëse s'duam që të përjashtohet asnjë, pra ne jemi dhe për ato për banesë të kalojnë.

Denisa Luarasi: Atëhere fjalën e ka zoti Xhelili.

Rolant Xhelilaj: Genti ke gjë, sepse se do të flas në emër të grupit.

Unë i mirëkuptoj edhe pozitivitetin, por dhe negativitetin e parafolësve. Pozitiviteti është në pozicionin qytetar. Ju vjen mirë që dhe shqetësimi i tyre dhe shqetësimi jonë edhe te mbledhja e kaluar dhe në komisione gjetën reflektim nga Bashkia nëpërmjet shqetësimit qytetar të ngritur në institucionin e bashkisë. Zoti Burgija, bëni thirrje, vijnë ta bëjnë shqetësimin te PD-ja? Nuk vijnë. Qytetarët s'kanë besim te PD-ja, kanë besim te institucioni, kanë besim te ne dhe ne reflektojmë. Reflektimi ju krijon një ngërç që deri ku shkon ky reflektimi, ekziston mundësia që ky lloj projektvendimi të votohet me ndryshime? Pa diskutim. Në politikën legjislative ku hyn edhe veprimtaria e Këshillit Bashkiak, çdo vendim mund të ketë ndryshime nga diskutimet dhe propozimet e anëtarëve të Këshillit Bashkiak, e grupeve përkatëse, të cilat marrin shumicën e votave. Në këto kushte propozimi ose indicia që vjen nga nënkryetari i bashkisë, por dhe nga institucioni i bashkisë dhe qëndrimet e komisionit dhe qëndrimi i grupit tonë është është një reflektim shumë pozitiv. Për mos nxjerrjen nga vlerësimi për dëmet e shkaktuara nga tërmeti të të gjithë atyre familjeve të cilat projektvendimi i kaluar apo ajo VKM e qeverisë lë një hije për efekt të aplikimit apo të pozicionimit në qytetin përkatës ku ka ndodhur edhe situata siç është qyteti i Durrësit. Kurse pjesa tjetër pastaj të marrin të tërën, të marrin tamam nuk ka lidhje me këto dy projekt vendime. Pika që ngelet në fuqi është, ata që kanë dy shtëpia, kontrolli është bërë, emrat kanë dalë, shqetësime nga ata me dy shtëpia do ketë, sepse çdo qytetar lufton për të drejtën e tij, nuk është gabim, por ky është, kjo është VKM-ja, ky është vendimi i Këshillit të Ministrave. Ne bëjmë pjesën tonë që është shumë e rëndësishme që të ndihmojmë qytetarët të cilët realisht janë dëmtuar nga tërmeti dhe mungesa e tyre në lista do të jetë pak e padrejtë në efektin e aplikimit apo në efektin e faktit që ai jeton në Durrës, kryen gjithë aktivitetin në Durrës, por mund ta ketë akoma vendbanimin diku tjetër. Në këto kushte në emër të grupit unë do propozoj që të miratohen me ndryshime dhe të hyjnë në fuqi plotësisht sipas propozimit që bëri kryetarja e Komisionit të Ligjeve.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zoti Xhelilaj.

Të lutem. Po mirë, ndize mikrofonin, merr fjalën.

Dritan Burgija: Meqë u ezaurua, padrejtësinë e përmendi dhe zoti Xhelili ndaj këtyre qytetarëve, nuk kam çfarë të shtoj më. Thjesht doja t'i bëja një pyetje bashkisë, nënkryetarit meqë e kemi këtu shqetësim qytetar ky. Kur bëhen qytetarët për të hyrë në banesat e reja? Domethënë kur është data, kur është caktuar, kur është shqetësim i madh për ato banorë që kanë marrë çelësat, është bërë procesi, por nuk janë akoma nëpër shtëpia. Do ishte me shumë interes që ju të jepshit një datë kur do hyjnë ato banorë atje, meqë jemi te pikat e rindërtimit.

Gentian Kallmi: Doja të pyesja konkretisht, rasti që janë marrë çelsa dhe nuk kanë hy nëpër shtëpia. Jo jo, po se kjo ishte pyetja? Nuk janë ndarë akoma çelësat se janë në fazë të përfundimit të punimeve. Shpresojmë brenda qershorit të bëjmë shpërndarjen e çelësve të banorëve. Është procesi i shorteut publik. Procesi i shorteut publik është caktimi i apartamentit.

Dritan Burgija: Interesi qytetar është kur do hyj në shtëpi.

Gentian Kallmi: Pyetja u formulua kanë marrë çelësat dhe nuk kanë hyrë në shtëpi.

Dritan Burgija: Në rregull. Atëherë kur bëhen këto qytetarë për të hyr në shtëpi?

Gentian Kallmi: Besoj dhe shpresoj brenda muajit qershor.

Dritan Burgija: Okej. Faleminderit.

Do jemi këtu prapë do e diskutojmë.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Burgija.

Faleminderit zotin nënkryetar.

Atëherë e hedhim në votim me ndryshime pikën katër, te rendi i ditës.

Kush është pro miratimit me ndryshim të rendit të pikës së katër të së rendit të ditës?

Dorina Milja : 27

Denisa Luarasi: Kundër? ...

Dorina Milja : 9

Denisa Luarasi: Abstenim? ...

Dorina Milja : 1

Denisa Luarasi: *27 pro. Atëherë me 27 miratohet me ndryshime pika katër e rendit të ditës.*

- Jepet fjala për projektvendimin e **pikës 5** të rendit të ditës, Komisionit Rregullores Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë edhe për pikën 5 ne i qëndrojmë po prapë të njëjtës ide dhe kemi të njëjtin qëndrim si për pikën 4, kështu që propozojmë të ketë ndryshime dhe kur të çelet votimi të miratohen ndryshimet. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Edhe për pikën 5 kërkojmë të kalohet për votim me ndryshime sipas diskutimeve të mëparshme. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.

Komente, pyetje ka, s'ka?

E zanuruam.

Atëherë kalojmë votim me ndryshim pikën 5 rendit ditës.

Kush është pro?

Dorina Milja : 27

Denisa Luarasi: Atëherë kundër?

Dorina Milja : 9

Denisa Luarasi: Abstenim ? po dhe 1 abstenim.

Mirë 27 pro miratohet me ndryshime pika pesë e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **e pikës 6** Komisionit Rregullores Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëhere kryetare në lidhje me pikën gjashtë, doja të ndalesha shumë shkurt. Në lidhje me pikën gjashtë ne propozojmë si komision që të ketë një reflektim dhe rishikim të kësaj pike, sepse duam që të ecim po prapë në frymën që, të diskutimeve që kishim deri tani ku në qendër të jetë qytetari. Kështu që i kërkoj Këshillit Bashkiak të ketë parasysh që të përfshijë tek pika gjashtë edhe ata persona që në vendimin e mëparshëm, në mos gaboj VKB nr.16, datë 21.05.2025 të llogariten dhe të merren parasysh. Bëhet fjalë për një vendim të mëparshëm kryetare të mbledhjes së kaluar, faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Faleminderit.

Ju lutem ta marri fjalën dhe Komisioni i Strehimit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti

Marsida Feshti: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike kërkon të bëhet ky ndryshim edhe kjo shtesë sipas ë kërkesës së Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.

Komente?

Jonuz Myshketa: Pra thjesht për t'u sqaruar pra në mbledhjen e fundit ku ne bëmë oponencën tonë që kalojmë me vendim Këshillit Bashkiak nga ana juaj pra do rikthehet ai, do rishikohet ajo. Zonja Mustafaraj, këtë thjesht për sqarim?

Pra, të gjithë ata që u përjashtuan për shkak të VKM-së ku nga ana ime ose jonë e opozitës u kërkuar që të implementohen. Pra, do bie poshtë ai vendimi i mëparshëm?

Sepse nëse po jam totalisht dakort dhe edhe njëherë komplimentime.

Joniada Musaraj: Zoti Myshketa mbiemrin unë ta them shumë saktë. Unë e kam Musaraj kështu që....

Jonuz Myshketa: Ndjes.

Joniada Musaraj: Atëherë pa problem.

Ëë, dëgjo, Myshketa, ne sot po bëjmë diskutime dhe që i qëndrojmë po prapë të njëjtës frymë. Kështu që ë propozimi im sot është kur them rishikim të rishikohen të gjitha vendimet që kanë në lidhje me këtë çështje dhe nëse më thua që sot e voton pro propozimin tim nuk e kuptova abstenimin te pika katër dhe pesë nga ana jote kur në fakt...

Jonuz Myshketa: Ja t'ja sqaroj pse, sepse aty në pikën...

Joniada Musaraj: Të them të drejtën abstenim, vetëm një diçka mund ta kuptoj votën pro dhe kundër po abstenimin të paargumentuar të jem e sinqertë më vjen keq kur e pashë, sepse ishte i vetmi karton që ishte abstenim...

Jonuz Myshketa: Ja ta argumentoj meqë, sepse ajo pikë nuk është e plotë për mua. E plotë do ishte nëse të gjithë ata që janë skualifikuar qoftë që kanë banesa të dy banesa qoftë ata që nuk kanë bërë aplikim duhet të implementohen të gjithë. Duke qenë që është një pikë e cila kundërshton njëra-tjetrën gjykimin tim nuk mund të votojë pro njëres dhe kundër tjetres. Atëherë abstenoj meqë më kërkua dhe unë kam detyrimin t'ju shpjegoj juve.

Joniada Musaraj: Vota është e juaja, absolutisht.

Jonuz Myshketa: Jo jo, ok dhe t'ja sqaroj, sepse besoj se këtu e dimë që nuk kam asnjë lloj kompleksi të sqaroj sepse jam për këtë punë këtu. Pra, një pikë ka qenë që kundërshton njëra-tjetrën dhe nuk mund të votojë pro dhe kundër njëres sepse kundërshtojnë. Atëherë absenoj, sepse pjesërisht jam dakort dhe pjesërisht jam kundër dhe prandaj rikthehem për sqarim nga ajo që thatë ju. Në pikën që votuat dhe kundërshtova për pallatin Kastrati, e cila sipas Akt Normativ nr. 9 duhet të marrin banesat po në atë pallat. Pra ju t'i rikthehemi atij akti, i cili atij vendimi që këshilli bashkiak i përjashtojë, këtë po thoni? Dhe nëse thoni këtë jam 100% dakord me këtë pjesë.

Joniada Musaraj: Atëherë vetëm një diçka që të jesh i qartë për pjesën e pikës katër dhe pesë. Propozimi ishte ky dhe njëherë do ta sqaroj. Nuk është miratim i pjesshëm apo jo, por ne i qëndrojmë asaj që është e zezë mbi të bardhë, që do të thotë ata që kanë banesë të dytë nuk do të përfitojnë. Aty ku ne shikojmë hapësira dhe interpretimi na e lejon që të mund të bëjmë diçka për qytetarët, ne do ta bëjmë.

Jonuz Myshketa: Më vjen shumë mirë që mendohet për qytetarët.

Joniada Musaraj: Kjo këmbëngulja dhe vendosja e vet që o kalojnë të gjithë o s'ka se ndryshe nuk e miratoj, në qëndrimin tim më duket pak pra të mos përfitojnë dhe ata që e kanë mundësinë, sepse ju doni me patjetër të jenë të gjithë pa përjashtim. E kanë të bazuar apo jo, ju takon apo s'u takon pastaj..., kjo ishte e gjitha.

Jonuz Myshketa: E nderuar zonja Musaraj, llogjika është këtu. Unë i qëndroj fort të drejtës së pronës dhe është një pronë, e cila është përfituar me djersë, i është prishur për shkak të fatkeqësive natyrore. Këtu nuk bëj me faj qeverinë. Absolutisht jo. As kërkënd, sepse janë gjëra që ne s'i parashikojmë dot. Mos harrojmë gjithë krijimin e Ministrisë, Rindërtimit e fondet që u tumbetuan me sukses e të tjerë, etjerë. Deri këtu okej, por prona e fituar me djersë nuk mund të iki me një të

rëndë të lapsit. Këtë them. Dhe nëse në VKM është shënuar që janë dy banesa që ato që kanë dy banesa brenda një qarku nuk përfitojnë për shkak të gjësë natyrore, fatkeqësisë, por është e shkruar po e njëjtën në të njëjtën VKM dhe kush nuk u bën aplikimin dhe kush ka banesë diku tjetër. Pra përfshihet e plotë, sepse këtu garantohet e drejta e pronës. Kjo është qëllimi im. Nuk është qëllim as të bëj politikë, as të bëj thirrje retorike dhe thirrjen e radhës së kaluar e bëra në mënyrë më njerëzore të mundshme dhe për më tepër me ju si juriste, ju solla në vëmendje të gjithë këshillit bashkiak. Besoj se deri këtu jam i qartë. Kjo është dhe absenimi im në dy pikat e radhës se po mos qenë ndryshimi jam totalisht kundër duke i qëndruar asaj që kam cenuar dhe në mbledhjen e kaluar.

Joniada Musaraj: Nuk të jep statusin e të strehuarit. Ndërsa kur ke dy banesa të prishet njëra, ke tjetra, nuk je jashtë. Kështu që të mos përfshijmë ata që nuk kanë bërë aplikim, mua tani po më duket pak realisht sikur s'kam kuptuar asgjë nga mbledhja e kaluar. Po më thua që ata që s'kanë bërë aplikim të mos përfshihen.

Jonuz Myshketa: Të përfshihen patjetër. Të përfshihen të gjithë. Prandaj isha dakort me propozimin tuaj pjesërisht. Të përfshihen dhe ata që s'kanë bërë aplikimin, sepse mund të jetë një gabim njerëzor dhe e cenova shparë. Të përfshihen dhe ato që kanë dy apartamente pasi jetën e bëjnë në një apartament ku ata kanë implementuar gjithë jetën e tyre. Pse ka një apartament diku në Golem, kjo nuk e bën që ai apartamenti që ka blerë në Durrës t'i fshihet. Këtë e kam hallin unë.

Joniada Musaraj: Epo tani. Kjo është ajo që e kemi të shkruar, do ta zbatojmë.

Jonuz Myshketa: Dakord VKM, VKM-t dëgjo ë më falni ë me VKM janë bërë shumë padrejtësi. Ne kemi në dorë si qytetarë të themi çka është e drejtë, çfarë është e padrejtë. Kaq. Kjo është ajo interesi i qytetarëve dhe e nis nga vetja ime, imprimis, sikur prona ime meqë pas kam dy apartamente që kam investuar, kam punuar, kam rrezikuar fort që të kem dy apartamente. Pse ma prishi tërmeti një meqë kam dhe një tjetër qoftë dhe në Tiranë ose qoftë dhe në Golem, nuk duhet të përfitoj këtë. Për më tepër ku ndërtohet për të njëjtin vend?

Joniada Musaraj: Myshketa, të them të drejtën duhet të falenderojmë të gjithë që patëm kryeministër në periudhën e tërmetit zotin Edi Rama se ta do ishim sot në kushte të tjera, do flisnim bashkë. Dhe reagimin që ka patur qeveria shqiptare në lidhje me tërmetin nuk e kanë patur as shtet europianë dhe besoj se informacion e kemi të dy bashkë. Kaq që e kemi. Kështu që ne i përgjigjemi qytetarëve për aq sa na e lejon ligji, për aq sa na e lejon interpretimi që ne i bëjmë bazës ligjore. Pastaj pjesa tjetër nëse ju personalisht ju duket i drejtë dhe e padrejtë kjo është pastaj, ky është pastaj qëndrim subjektiv. Nëse ti ma rrëzon pastaj me arsyetim ligjor është debat tjetër.

Jonuz Myshketa: Tashti unë sapo e cënova para që në bazë të ligjit, por ju po bëni politikë kur pak më parë kolegëve i thatë mos bëni politikë lidhje me këtë çështje.

Joniada Musaraj: Nëse do bëja politik ...do ta kisha hapur fjalën time ndryshe sot .

Denisa Luarasi: Ka kaluar koha, ju lutem.

Jonuz Myshketa: Kjo është subjektive, se e bëri kryeministri apo dikush tjetër, kjo është tërësisht subjektive. Unë nuk doja të futesha në këto kanale për mua prevalon interesi i qytetarëve, e drejta e pronës.

Joniada Musaraj: Nëse do te bëja politikë, fjala ime do niste ndryshe sot.

Jonuz Myshketa: Si i djathtë bazohem tek e drejta e pronësisë.

Flutura Kasa: A mundem?

Joniada Musaraj: Këtu jam këshilltare e qytetarëve të Durrësit, pavarësisht se vi nga një logo partie.

Denisa Luarasi: Ju lutem.

Flutura Kasa: A mund të flas pak? Ju lutem.

Denisa Luarasi: Ju lutem fjalën e ka zonja Kasa.

Flutura Kasa: Atëherë meqënëse jemi këtu te pallati Kastrati shoh listën që mungojnë 18 emra. Nëse këto 18 emra janë njerëz që nuk kanë bërë aplikim, atëherë i bie që të përfitojnë nga kjo që sapo u fol. Ndërsa përsa i përket debatit që bëri edhe Joni, ne e thamë dhe herës tjetër nuk kemi asnjë lloj fuqie ligjore për të rrëzuar VKM-të dhe jam me atë. Kush ka dy shtëpia, le të mbajë atë që ja ka shpëtuar Zoti edhe ta shtrëngojë fort, sepse kjo është një ndihmë që i dha qeveria shqiptare qytetarëve që ngelën pa shtëpi. Edhe sa më dhemb për shtëpi të jeni të sigurtë që s'ju dhem asnjëri që jeni këtu, se e kam 30 vjet që bredh gjyqeve për një copë shtëpie dhe sot jam 64 vjeç edhe s'kam shtëpi. Prandaj atij që i është prish shtëpia e dytë le t'i japi forca vetes ta blejë prapë.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja.

Atëherë ju lutem, ju lutem.

Munir Konesha: Çfarë do të ndryshojmë në këtë vendim? E kemi prekur vendimin e kam përpara. Çfarë, ku do ndryshojmë se s'po e kuptojmë. Do ta miratojmë kështu apo është një tjetër?

Denisa Luarasi: Do të shtohen personat.

Munir Konesha: Ku është e shkruajtur? Propozimi për ndryshim bëhet me shkrim të jemi dhe në dijeni krejt normal.

Denisa Luarasi: Atëherë një sqarim nga kryetarja. Ju lutem zonja Musaraj të lutem.

Munir Konesha: Po gjashtë s'është votuar. Çfarë do të ndryshojmë?

Joniada Musaraj: Konesha, zoti Konesha e ke tonin e zërit pak më të ashpër.

Denisa Luarasi: Zoti Konesha, ta dëgjojmë kryetaren e komisionit.

Joniada Musaraj: Atëhere, atëherë një diçka .

Denisa Luarasi: Ju lutem pak qetësi.

Joniada Musaraj: Atëhere në lidhje me pikën 6 na vjen shqetësimi i vendimit të mëparshëm Konesha me numër 16 i datës 21. Më kupton drejt? Pra me pikën gjashtë sot lidhet shqetësimi i një mbledhje të mëparshme. Prandaj po të them, që personat.....

Po ta bëj ... po e do me shkrim Konesha? Po mirë mo fjala e kryetares së Komisionit Çështjeve Juridike.....

Jo, atëherë unë propozimin ta bëj zyrtar.

Denisa Luarasi: Atëherë fjalën e ka kryetari i grupit zoti Xhelili.

Joniada Musaraj: Propozimin ta bëj zyrtar sot unë, që të përfshihen dhe personat.

Rolant Xhelilaj: Pika 6 , lexoheni çfarë thotë pika e gjashtë dhe miratohet nga anëtarët e Këshillit Bashkiak siç thotë pika e gjashtë, por në pikën gjashtë vlerësohen ata banorë që ekzistojnë te ai pallati pa ata të cilët me datën 21.05.2025, ne duke mbështetur VKM i skualifikuam për mungesë aplikimi dhe për mungesë vendbanimi. Dhe kërkojmë ne, pastaj juristët të na e sqarojnë kalon direkt këtu në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me ndryshim apo ka nevojë që kjo pikë të ketë plotësim. Në qoftë se, për opinionin tim ajo mund të kalojë dhe këtu se shtohet aty dhe thuhet në vlerësimin, Muka mund të ketë tjetër opinion, por në vlerësimin e sipërfaqeve të banimit të pallatit X dhe Y të merren në konsideratë të gjithë banorët, të cilët edhe janë skualifikuar nga data 21.05.2025 për aplikim dhe për vendbanim jashtë Durrësit. Ata që janë dy shtëpia pastaj nuk kemi çfarë i bëjmë. Dëshirën e kishim të madhe, sepse jemi dakort me Jonin që thotë prona është e rëndësishme, por nuk konsiderohet i pastre Joni. Ai konsiderohet me dy shtëpia. Pastaj ka vend për diskutim. Janë grupi i parlamentar, megjithëse ju s'bëtë dot gjë, që ta ngrejë atje edhe VKM-ja, të rishikohet a ku di unë, të plotësohet e gjitha me radhë. Sot ne po punojmë me dëshirën më të madhe pozitive të shfrytëzojmë atë VKM për ato elementë, të cilat na lënë mundësinë në fillim këshilli, pastaj bashkisë si institucion, por dhe neve të dy grupeve, sepse pavarësisht votës kundër, qëndrimi edhe i Burgisë dhe i Mukës, por dhe i Jonit është pozitiv, sepse pranimi që ky lloj ndryshimi është në të mirë të qytetarëve është hap goxha përpara. Pastaj që ta çojmë deri poshtë vuajmë një çik për këtë pjesë. Duam të qëndrojmë atje te bunkeri dhe te tuneli edhe te ai pozicioni luftarak i Jonit, por është qëndrim korrekt. Prandaj këtu Joniada dhe nuk e di edhe nga grupi tjetër nga pikëpamja juridike: Kanë mundësi të na shjegojnë kjo pikë kalon me këtë propozim që bëj unë apo jo ?

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj. Fjalën e ka Joniada.

Joniada Musaraj: Jo, thjesht për ta bërë më të thjeshtë siç u veprua për pikën katër dhe pesë kryetare, kërkoj sot që të mos ketë shtyrje për pikën gjashtë, të përfshihen te kjo listë e pikës

gjashtë, pra të miratohet pika e gjashtë, të përfshihen dhe ata persona që, në vendimmarrjen e mëparshme ne morëm një vendim tjetër. Pra, dua që të miratohet sot.

Unë si komision e propozoj për sot që të mos ketë vonesa dhe të ketë po prapë një përshpejtim. Mos të ketë vonesa. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë. Faleminderit.

Po zoti Muka.

Ardian Muka: Me thënë të drejtën, vjen edhe për të qeshur edhe për të qarë. Se për pikën katër dhe për pikën pesë nuk e shkelim kushtetutën për atë, më fal VKM-në, për atë vendim që morëm për pallatin tek Ujësjiellësi, që njihet Kastrati. Nuk e shkelim VKM-n. Ndërkohë që propozojmë shkeljen e VKM-së për pikën katër dhe pikën pesë, po e shkelim pjesërisht. Tashti ose shkelet ose nuk shkelet. Ne jemi që mos të shkelet, sepse diçka pa pa rend, pa ligje është është diçka që rri në ajër pastaj. Prandaj dhe propozuam për pikën katër dhe pikën pesë të ishte shtyrë. Në momentin që bëjmë shtyrje vinte ndofta projektvendimi i ndarë në dy pjesë, pjesa që kualifikohen, për ato që kanë një banesë ndofta jashtë Durrësit dhe që nuk kanë bërë aplikimin dhe ato për variantin tuaj për ato persona që kanë apartament të dytë në Durrës ose jashtë Durrësit t'u kalonin të dyja me dy propozime të ndryshme ku natyrisht ne do kishim votuar pro, për pjesën e parë dhe do kishim votuar kundër, për atë për banesën e dytë. Pse? Koncepti i pronës është një atë pronë e ke përfituar ose me trashëgimi ose me blerje, automatikisht kush e ka blerë ka paguar taksat në këtë shtet, është shpall situata e gjendjes së emergjencave civile, automatikisht do t'i japësh lekët. Të tjerët janë të gjitha artificia. Përsa i takon pikës gjashtë, këtu sqarova pak edhe pse ishte vota jonë kundra. Nuk ishte kundra katër dhe pesës, por mënyra se si sillet, pra sillet po e shkelim, po e shkelim me një propozim të mazhorancës. Ndërkohë atë tjetrën nuk e shkelëm, sepse e donte opozita.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka,

Ardian Muka: Më fal një sekondë. Për pikën gjashtë do thoja, pika gjashtë është shumë e qartë. Nuk ka lidhje me përjashtime apo me shtesa. Do propozoja ta kalojmë kështu siç është pikën gjashtë dhe për pallatin Kastrati të vijë një propozim i ri i ndarë në dy nënpropozime. Ata që e përfitojnë meqenëse nuk kanë bërë aplikimin apo kanë një banesë, më fal jashtë qytetit dhe pjesa tjetër që e ka banesën, banesë të dytë, meqenëse e keni shumë merak e nuk doni me ja dhënë atyre. Pra për ne pika gjashtë kalojë kështu siç është dhe jemi pro që ta kalojmë kështu siç është ka lidhje thjesht me shpërndarjen e apartamenteve të atyre që i takon apartamenti. Ndërsa shtesa që duam t'i bëjmë të vi si një projekt ligji i ri me mbledhjen e radhës, mundësisht e ndarë në dy pjesë dhe argumentuar pse. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Okej, faleminderit zoti Muka.

Zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Vetëm një diçka. Zoti Muka në asnjë rast dhe në asnjë moment nuk bëmë një veçim të dy kritereve që ne i qëndrojmë që ka të bëjë me aplikimin dhe me vendbanimin. Ajo që është e përbashkët në çdo vendimmarrje që ne kërkojmë sot nga ana juaj ka lidhje me banesat e dyta. Ndërsa kriteret që ne kërkojmë të t'i përfshijmë, pra dy kriteret që unë përmenda që ne

kërkojmë t'i përfshijmë këta persona sërish janë po të njëjtat. Në asnjë rast nuk u bën tre nga dy nuk u bën tre në asnjë rast, sepse ja po ta them unë atëhere, sepse vendimmarrjet në çdo institucion edhe rishikohen zoti Muka dhe s'ka asgjë të keqe të interpretohen sërish dhe po të them, ndoshta sot ndoshta, sot të preva hovi se ishte përgatitur, ke menduar sot që do bëjmë namin te pika katërt dhe pesë. Personalisht është e vërtetë kjo gjë, sepse të pashë dhe tek mënyra se si e nise fjalën ishte përgatitur ndryshe, por ne nuk e mbyllim ka një diçka jo vetëm Bashkia por dhe këshilltarët e majtë nuk e mbyllin mendjen në momentin që dalin nga këshilli bashkiak ne lexojmë, interpretojmë, mendojmë, shqyrtojmë, diskutojmë derisa të gjejmë atë më të mirën e mundshme. Dhe po të përsëris që dy kritereve që ne i qëndrojmë në çdo pikë që u diskutua sot ka të bëjë me propozimin e komisionit tonë që të përfshihen ata persona që nuk kanë bërë aplikim apo që kanë vendbanimin diku tjetër.

Në lidhje me banesat pastaj të dyta.....

Denisa Luarasi: E ka marr fjalën zoti Myshketa.

Faleminderit Musaraj.

Z. Myshketa.

Jonuz Myshketa: Faleminderit për fjalën.

Në lidhje me pikën gjashtë, për pikën siç është duke shqyrtuar gjithë materialin thuhet që në pikën gjashtë është bërë me bashkëfinancim dhe me donacion. Donacionin mos gaboj zonja Musaraj kam dhe një pyetje për ju nga ana juridike nga ana e jurisprudencës. Pra aty është Emiratet Arabe në mos gaboj që kanë financuar objektin. Kriteret e përzgjedhjes së banorëve janë sipas çertifikatës aktuale të gjendjes civile të përbërës familjare dhe ka shprehur vullnetin investitori që ka bërë pallatin në fillim për të cilën e përgëzoj që të japë të investojë te 3500 m² shtesë në atë objekt për t'i kompensuar pjesën takuese që kanë pasur që në fillim. Pra me përzgjedhjen që bën Bashkia sipas gjendjes familjare dhe nëse ka qenë një person i vetëm, ka marrë një shtëpi që ka qenë 3+1 ka pasur mundësitë, pra i takonte me VKM-në 65 m² ose 80 m², ç'rëndësi ka? Investitori që shpreh vullnetin për të qenë bashkëfinancues i ka akorduar dhe pjesën tjetër. Deri këtu jemi shumë ok. Dua të ndalem pak tek Akti Normativ nr.9, neni 21 dhe kjo është për ju, që edhe unë sqarohem në aspektin juridik, por dhe qytetarët që na ndjekin. Pra, thuhet qartë në nenin 21 me financim, pra rindërtimi i objekteve të shembura nga fatkeqësia natyrore në të njëjtin truall dhe flasin në po të njëjtin truall. Me financim nga fondi i rindërtimit apo investitor nga apo me investime nga donatorë ndërtohen ose rikonstruktohen ndërtesat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore në truallin ekzistues. Sipas parashikimit të këtij akti, përfitueset e njësive të banimit në objektet e reja janë pronarët e njësive të banimit të objekteve të shembura në trojet e të cilëve ndërtohen objektet e reja. Struktura e njësisë e banimit që kalon përfituesve nuk duhet të jetë më e madhe se struktura e njësisë së banimit që përfitojnë. Pra të gjithë ata që kanë pasur një pronë të tyre të përfituar në bazë të një kontrate dhe çertifikata e pronësisë e reklamon në këtë akt thuhet që nuk marrin më tepër se ç'kanë pasur. Pra përfitojnë të gjithë ata që kanë pasur një banesë për ndërtesat që rindërtohen në të njëjtin truall. Jam i saktë këtu. Pra është shkelur VKM-ja?

Denisa Luarasi: Nënkryetari përgjigjet.

Gentian Kallmi: Atëhere thjesht për një sqarim ju referoni aktin normativ nenin 21 për subjektet përfituese pas rindërtimit në të njëjtin truall. Në qoftë se shikoni në nenin 5 të VKM-së që flet

kush janë subjektet përfituese, në pikën 3 të tij citohet, nuk është subjekt përfitues, individi ose familja që kanë pronësi ose posedim të ligjshëm më shumë se një banesë në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore. Pavarësisht nëse banesa që është dëmtuar nga fatkeqësia ka qenë vendbanim i zakonshëm, dhe vazhdon, në bazë kjo ky është kategorizimi i subjekteve përfituese dhe në nenin 21 flet për subjektet përfituese të të njëjtit truall.

Jonuz Myshketa: Pra ju thoni që në nenin 5, më fal që ndërhy thjesht për sqarimin publik, pra dhe për të njëjtin objekt që ndërtohet të njëjtin truall edhe aty

Gentian Kallmi: Aty përcakton kush janë subjektet përfituese dhe më poshtë nëndetajohen subjekt përfituese pas rindërtimit në të njëjtin truall ose në zonat e reja për zhvillim.

Jonuz Myshketa: Pra interpretimi, ju thoni që neni 21 vjen si rrjedhojë si pasojë e subjekteve përfitues në nenin 5 dhe më pas. Atëherë unë interpretova ndryshe prandaj kërkova dhe opinionin juridik, sepse mua më duket që flet për një rast veçmas VKM-së, sepse është një akt normativ i cili këtu shprehet qartë për objektet që janë ndërtuar në të njëjtin truall jo diku tjetër, se mund të bie dakort dhe parimisht por dhe me VKM-n që nëse ndërtohet diku tjetër ok. Por ata që janë pronarë dhe pas shëmbjes së objektit janë pronarë po të truallit. Pra ju jeni bazuar tek neni 5, i cili përcakton subjektet përfituese. Okej. Zonja Musaraj e kishte po këtë shpjegim apo e ezauroi nënkryetari? Ndoshta jo?

Denisa Luarasi: Ju lutem.

Jonuz Myshketa: Në vitin 2021 banorët e këtij pallati dhe ato që janë skualifikuar sot kanë nënshkruar një marrëveshje dhe me subjektin ndërtues në fillim dhe kanë qenë të kualifikuar me vendim Këshillit Bashkiak të 2021 në mos gaboj. Sot ata ë nuk marrin banesat e tyre duke krijuar, duke humbur pronën dhe duke krijuar një pasiguri juridike dhe ekonomike. Apo e kam gabim?

Denisa Luarasi: Kalojmë në votim.

Faleminderit zoti Myshketa.

Po zoti Burgija.

Dritan Burgija: Na vjen mirë që edhe pasi mbarojnë mbledhjet e Këshillit Bashkiak ju reflektoni mbi kundërshtitë tona dhe me një mbledhje vonesë na sillni ndryshimin këtu. Kjo është për t'u përgëzuar pavarësisht vonesave, është për t'u përgëzuar, siç na vjen keq për çdo qytetar që me gjak ka pronë të dytë, e kanë përfituar me, siç e shprehu zoti Muka, me blerje apo me trashëgimi, por është pronë dhe ju vini dhe fshiheni këtu pas VKM-ve, që e keni miratuar vetë, vetë e dini se për çfare e kam fjalën. Kështu që na vjen keq për çdo qytetar, që ju e trajtoni në këtë mënyrë dhe keni kurajon dhe flisni në emër të qytetarëve dhe për interesin qytetar këtu. Sa i përket ndryshimeve jam i prirur për të deklaruar votën pro, sepse është vërtetë në interes të atyre qytetarëve të atij pallatit atje. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro kalimit të pikës 6 me ndryshime?

Dorina Milja : 37 pro

Denisa Luarasi: Ok, dakord.

Kundër?.....

OK miratohet 37 pro me ndryshime, pika 6 e rendit të ditës.

- Jepet fjala për projektvendimin e **pikës 7** Komisionit Rregullores dhe Çështjes Juridike zonjës Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëhere kryetare në lidhje me pikën 7, ne si komision jemi shprehur dakort në fakt me shumicë votash. Vetëm kisha një propozim që të shtohet si pikë shfuqizimi i Vendimit të Këshillit Bashkiak numër 102, datë 28.10.2024 “Për procedurat dhe formulat e shpërndarjes së subvencionimit për operatorët e shërbimit të transportit publik qytetas në bashkinë Durrës”.

Ky ishte sugjerimi i vetëm që kisha. Faleminderit.

Denisa Luarasi: I jepet fjala Komisionit Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonjës Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me pikën 7 të kalojë për votim në Këshill. Gjithashtu propozojmë edhe ndryshimin që kërkoi Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.

E merr fjalën Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Komisioni i Transportit dhe Trafikut Rrugor e kalon për votim në Këshillin Bashkiak, duke propozuar ndryshimet që tha Komisioni Juridik.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

Komente, pyetje kemi?

Po zoti Muka.

Ardian Muka: Me thënë të drejtën, ne në komision kërkonim që të kishim edhe përfaqësuesin e bashkisë për disa pyetje, të cilët nuk arritëm që t'i bënim. Nuk e di është sot apo jo? Gjithsesi unë pyetjet po i parashtroj dhe do preferoja të kishim përgjigje.

Natyrisht që transporti publik është një hallkë shumë e rëndësishme, shumë e rëndësishme për një qytet, sidomos për një qytet turistik siç është qyteti i Durrësit, ku në problematikat kryesore që ndeshim po t'i shohim në intervistat dhe në opinionet që japin turistët është që, është qytet që ka pak shërbim për sa i takon pjesës së shërbimit publik. Natyrisht ato jo domosdoshmërisht duhet të lëvizin me taksì. Besoj që do i shërbente më mirë edhe turizmit që është një nga kolonat mbajtëse po flasim të hyrjeve, të ardhurave të bashkisë së Durrësit. Pra është një komponent goxha i rëndësishëm pjesa e shërbimit të transportit publik. Në argumentimin që na keni dhënë në relacion, unë kam dy tabela, me thënë të drejtën, të cilat janë pothuajse njëlloj njëra me tjetrën dhe nuk arrij të bëj diferencën. Pra, flasim për të njëjtën periudhë, për të njëjtat zëra dhe ka

diferenca tabela e parë me tabelën e dytë. Do doja të dija kush është diferenca e të parës me të dytën.

Gentian Kallmi: Ë, mundem që të ecim pak hap pas hapit. Ok. Atëherë në lidhje me dy tabelat, ato i referohen numrit të biletave të shitura nga dy operatorët që operojnë

Ardian Muka: Pra për qytetarët durrsakë të gjithë e dinë që shërbimi brenda përbrenda qytetit paguhet një tiket, një biletë për 40 ALL, 400 ALL të vjetra , të njëjtën tarifë paguajnë qytetarët e kryeqytetit në të gjitha linjat e shërbimit brenda qytetit të Tiranës.

Tani pyetja ime është : Rritja që propozohet apo subvencioni, jo rritja, subvencioni që propozohet, meqënëse Tirana nuk jep asnjë lloj subvencioni, subvencioni është vetëm për studentët dhe për pensionistët. Pjesa tjetër, nuk ka subvencion. Tirana i ka autobusat, flotat e autobusave shumë herë më të rinj seç i kemi operatorët që japin shërbimin në Durrës. Tirana natyrisht mund të ketë lëvizje, lëvizje të tjera ndofta pasagjerësh dhe kjo mund të bëjë diferencën me Durrësin, por gjithsesi këto duhet të ishin marrë, sepse për mendimin tim nuk është justifikuese ë problematikat që operatorët kanë shtruar. Pra, rënia e numrit të pasagjerëve nga pandemia. Pandemia ka kaluar 2019-2020. Struktura e udhëtarëve që vihet re, numri i fëmijëve zero deri në gjashtë vjeç. Është rritur kaq shumë në Durrës me problematikat që kemi ne me popullsinë. Është rritur kaq shumë numri i pasagjerëve deri zero deri në gjashtë vjeç sapo i jep problematika transportit të transportit publik. Nuk më duket edhe ky argument shumë i bazuar. Luhatja e çmimit të naftës. Po jam 100% dakort sepse nga momenti që ato ndofta kanë lidhur kontratën deri në momentin që flasim sot që kërkohet subvencioni, nafta është rritur sikurse dhe problematikat që kanë me pagesat e operatorëve si të fatorinave ashtu dhe të shoferave dhe kjo dihet që janë rritur. Po për këtë neve kemi pasur në fuqi një Vendim të numër 102, datë 28.10.2024 që kishte lidhje me mënyrën se si do bëhet rivlerësimi për subvencionin. Pra kompanitë kanë detyrim të bijnë disa informacione dhe në bazë kësaj do ishte Sektori i Transportit pranë bashkisë Durrës, i cili do përcaktonte se sa do ishte pjesa e subvencioneve. Propozimi që na vjen thjesht do ta rrisim 10 lekë për biletë, pra 100 lekë të vjetra për biletë është 25% e vlerës së biletës, dhe për ta argumentuar, pse është ky 25% nuk mjaftojnë këto 4 argumentet, por u donte besoj një analizë pak më e thelluar mbi këtë. Dhe për mendimin tim, neve e kemi procedurën dhe formulën me numrin 102, me vendimin 102 të 2024-s, tetor 2024. Pra them nuk kemi pse ta bëjmë. Nuk ka ardhur e argumentuar 100% pse duhet ky 100 lekshi. Kush do ta argumentojë që sa bileta janë shitur pastaj? Kush do ta kontrollojë se sa bileta janë shitur? Ndërkohë, sepse vitin tjetër në 2026-ën mund të thonë që kemi 4 milion pasagjerë që kanë lëvizur për 4 milion. Pretendojnë 10 lekshin dhe kështu me radhë.

Denisa Luarasi: Po zoti nënkryetar mund ta sqarosh?

Ardian Muka: Jo. Ok. Domethënë për mendimin tim rritja nuk e ka argumentimin e duhur ndërkohë që ne kemi strukturën se si e ka aprovuar Këshilli Bashkiak se si duhet bërë kjo rritje.

Denisa Luarasi: Po zotin nënkryetar.

Ardian Muka: Faleminderit.

Denisa Luarasi: Fjala për ju.

Gentian Kallmi: Atëherë përse i përket pyetjes tuaj në lidhje me vendimin paraardhës dhe vendimin dhe projektvendimin e sotëm është zgjedhur mënyra e subvencionit, është bërë një analizë, sepse ne kemi një vlerë buxhetore të miratuar vjetore për subvencionin e transportit. Sipas llogarive tona dhe të numrit të biletave aktuale jemi në të njëjtat linja me fondin tonë buxhetor për vitin 2025. Aktualisht është mënyra më e duhur mendojmë ne si institucion, për të inçentivuar subjektet, të cilat operojnë në linjën e transportit dhe nga ana tjetër është mënyra më e lehtë e verifikueshme numri i biletave nëpërmjet Drejtorisë Rajonale Tatimore, duke bërë kryqëzimin dhe kërkuar informacionin e saktë dhe zyrtar për numrin e biletave të shitura çdo muaj.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zoti nënkryetar.
Po z. Muka, pak shpejt .

Ardian Muka: Nuk jam dakort me llogjikën që përdorni. ndofta unë mund të isha që tu rriste edhe 20 lekë, por për të arritur aty do kërkonim që operatorët, kundrejt një kontrate, meqënëse ju thoni që Bashkia e paska këtë fondin dhe kemi një fond të aprovuar që jo domosdoshmërisht mund të jepet, se në momentin që operatorët nuk kanë nevojë dhe nuk jepet dhe ato mund të përdoren fondet për diçka tjetër, por operatorët duhet shtrënguar si në rinovimin e flotës, në respektimin e orareve, në trajtimin e gjithë pasagjerëve që janë si njerëz. Pra, aty kur duhet të nezë kondicioneri të funksionojnë kondicionerët, aty ku duhet i ngrohti të funksionojë pjesa e të ngrohit. Për linjat, për stacionet e linjave, duhet parë stacionet e linjave, kemi ankesa që na vijnë njerëzit nga Universiteti, vjen linja, nuk marr, nuk ndalojë te Universiteti, sepse nuk marr studentë. Tashi këto besoj që i referohen edhe pranë bashkisë. Pra ka një sërë problematikash që operatorët i kanë, i kanë të trashëguara. Natyrisht, edhe ato mund të jenë me problematikën që kanë ngrejt naftën, shoferët nuk qëndron pjesa tjetër. Unë besoj që Bashkia nuk do arrij ta monitorojë siç duhet këtë operacion. Prandaj do preferoja dhe do thoja të ngeli në fuqi ndofta akoma dhe një vit formula që juve keni zbatuar deri tani, sepse është një formulë që të cilën ju mund ta aplikoni kilometrat ato siç është formula dhe vitin tjetër në qoftë se do shohim që do ketë rritje, pra rinovim të flotës, përmirësim të kushteve të transportit ndaj pasagjerëve dhe të gjitha mund të vihet këtu me këtë propozim. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka.

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 7 të rendit të ditës me ndryshime sipas propozimeve nga komisionet përkatëse?

Dorina Milja : Pro 26.

Denisa Luarasi: Kundër?

Dorina Milja : 9

Denisa Luarasi: Abstenim?

Atëherë me 26 vota pro, miratohet me ndryshime projektvendimi i pikës 7 të rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 8**, Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Jonada Musaraj.

Joniada Musaraj: Kryetare dhe në lidhje me pikën tetë, komisioni ynë e propozon që të kalojë sot në këshill. Ne votuam me shumicë votash. Faleminderit dhe nuk kemi asnjë sugjerim.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, zonja Joniada Mamo.

Joniada Mamo: Përshëndetje.

Edhe komisioni jonë miraton me shumicë votash edhe i kërkon këshillit ta miratojmë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Mamo.

Komisioni i Politikave Zhvillimit të Turizmit, zonja Alketa Ngjeçi.

Alketa Ngjeçi: Përshëndetje.

Komisioni i Turizmit ka shqyrtuar pikat e rendit të ditës dhe ramë dakort për miratimin e tyre në mbledhje.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Ngjeçi.

Komente, pyetje ka për pikën 8?

Po zoti Muka.

Ardian Muka: Në fakt në komision ishte përfaqësuesi i bashkisë, të cilit i ngritëm disa pyetje, na u dhanë disa shpjegime, por që nuk ishin gjithsesi shteruese.

Me ndryshimet që kanë ndodhur për sa i takon rregullores për marrjen e të drejtës të parcelave të plazhit, trajtimit të parcelave të plazhit, Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik, po lexoj materialin që na keni sjellë, pika 5, neni 5, pika 4, Vendimet e Këshillit të Ministrave 649, 6/10/2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit veprimtari stacionit të plazhit” të ndryshuar ka miratuar hartën e stacionit të plazh publik dhe të cilën pajisur me numër të veçantë identifikues. Me rregulloren e re për të gjithë këshilltarët, por edhe për qytetarët parcelat e trajtimit të plazhit mund të merren vetëm nga hotelet, pra njësitë e shërbimit restorante bar, pabe që mund të jenë në vijën e parë të plazhit nuk kanë të drejtë, natyrisht ato aplikojnë por në rregullore të drejtën initiale e kanë hotelet. Pjesa tjetër kundrejt rregullores së re të këtij ligji që sapo përmenda në vijë lineare në 1.000 m, 70% i përket publikut dhe 30% i përket privatit. Pyetjet që neve i drejtuam specialistit të bashkisë kishin lidhje me atë që kemi një studim fizibiliteti që sa do jetë, sa është se po flasim sot 10, 11, 12 qershori, ndërkohë që sezoni turistik për atë çfarë është dhënia licenca ka filluar me 15 maj. Sa është sipërfaqja dhe kërkesat dhe automatikisht sipërfaqja e dhënë, e aprovuar për hotelet nga ana e bashkisë së Durrësit?

Kemi një studim fizibiliteti, pra kemi një rënie të sipërfaqes në krahasim me atë çfarë ka qenë viti 2024 apo dhe viti 2023? Pse? Në qoftë se neve kemi rënie, automatikisht kemi rënie të ardhura për bashkinë e Durrësit, kemi më pak fonde për të investuar në qytet. Duke pasur parasysh që pjesa e rërës është një e mirë, që Zoti na e ka falë. pse mos ta shfrytëzojmë. Natyrisht e thënë këtë, ndofta do jetë më shumë 30%-shi i pjesës publike. Por deri më sot me gjithë ato problematikat që kemi pasur nuk kam qenë që pjesa e 30%-it nuk ka qenë e mjaftueshme për plazhe publike. Problemi ka qenë që 30%-i nuk ka qenë i shpërndarë në mënyrë uniforme për

gjatë bregdetit, gjë të cilën edhe në këtë rast neve nuk e kemi zgjidhur. Fakti që i japim të drejtën akoma hoteleve, ato aty ku janë aty do ta ushtrojnë aktivitetin, ndërkohë që kemi në zonifikim plazhi i menaxhuar. Plazhi i menaxhuar presupozon dhe këtë ja kërkuam edhe specialistit, pra do jenë sipërfaqet të cilët do të marrin hotelet, do jenë sipërfaqet të cilët do menaxhohen nga ana e hoteleve dhe pjesa tjetër është plazhi publik. Në konceptin tone, dhe këtë e pyetëm dhe specialistin, tha që besoj që rënia mund të jetë deri në 50 me 50, pra të kemi 50% sipërfaqe të shfrytëzueshme nga ana e privatit dhe 50% ngeli për publikun, por kjo ishte e thënë e pajustificuar dhe pa e bazuar në një studim paraprak, të paktën e thënë nga ana e specialistit.

Do kërkonim një informacion sepse në qoftë se ne do provojmë kështu siç është automatikisht do kemi një rënie të ardhurash. E para.

E dyta, rritja e sipërfaqes së lirë do bëjë të mundur rritjen e mundësisë së abuzimit, sepse duke mos e pasur në administrim lokalet, automatikisht ato, këtë shërbim e kanë dhënë gjatë të gjithë këtyre viteve. Pjesa e publikut do okupojë atë që do të do të zërë..... Pjesa tjetër do zihet gjithsesi nga këta që ushtrojnë aktivitetin në zonën në fjalë. Besoj që do okupohet nga këta që kanë lokalet pa kryer pagesat pranë bashkisë. Prandaj pyetja ime është : Mos na kthehet në kundrapedal ky veprim që neve po kryjmë? Pra aprovimi që po i bëjmë thjesht hotelerisë? Dhe duke mos ja dhënë të drejtën. Dhe një pyetje tjetër është : Hotele, të cilat janë në qendër të Durrësit kanë të drejtë të aplikojnë për zonë plazhi?

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka

Ardian Muka: S'ka problem me dhoma.
Faleminderit.

Gentian Kallmi: Në lidhje me pyetjet tuaja unë do ja kaloj fjalën kolegut tim zëvendëskryetarit Renis Mullaj, i cili është dhe pjesë e grupit të punës për këtë pikë.

Renis Mullaj: Përshëndetje.

Në lidhje me pyetjen e parë besoj se në komision ishte një sqarim nga ana jonë, por gjithsesi dhe për kolegët këshilltar po bëjmë një sqarim tjetër. Përsa i përket një studim fizibiliteti ju bëj me dije, nuk ka. Ne si njësi e vetqeverisjes vendore e propozojmë hartën sipas kriterëve që ka përcaktuar VKM-ja, në të cilën siç e thatë dhe ju në 1.000 m vijë lineare plazh, 700 janë në plazh privat dhe 300 duhet të jenë në plazh publik. Sa i përket pyetjes në lidhje me të ardhurat, nuk kemi një informacion të saktë pasi nuk është Bashkia që bën shqyrtimin e aplikimeve që do të thotë sa subjekte janë miratuar, me sa sipërfaqe, me sa numër dhomash dhe sa është të ardhurat që në fund të vitit do t'i shkojnë bashkisë. Besoj me mbylljen e sezonit turistik ne bëjmë një bilanc sa i përket numrit, sa i përket të ardhurave të nga tarifa e plazheve, por konkretisht nuk kemi një të dhënë të saktë për shkak, sepse nuk është Bashkia ajo që e përcakton që kush do jenë subjektet përfituese në këto parcela plazhi. Ne si njësi e vetqeverisjes vendore kemi detyrim ligjor vetëm të propozojmë sipas kriterëve të përcaktuara në VKM dhe pastaj janë organet e tjera që janë grupi teknik i shqyrtimeve të aplikimeve pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, që do bëjë miratimet. Në lidhje me pyetjen e parë besoj se kemi një sqarim nga ana jonë.

Përsa i përket pyetjes së dytë lidhje me kriterin e largësisë, përsa i përket hoteleve, të cilët janë apo operojnë në qytetin e Durrësit, por a mund të marrin një stacion plazhi. Ëh, nisur nga ajo që VKM-ja përcakton, nuk ka një kriter largësie fiks. Nuk shprehet në qoftë se, sa duhet të jetë

largësia minimale që një hotel të marri një strukturë akomoduese të marri një parcelë plazhi dhe ajo pastaj është në varësi po të grupit teknik të shqyrtimeve të aplikimeve. Në qoftë se ata e shohin të përshtatshme që kjo strukturë akomoduese i plotëson këto kriteret, mendoj mund t'ia japin ndoshta dhe mund ta skualifikojnë. Po prapë nuk është Bashkia ajo që e shqyrton apo e miraton një strukturë akomoduese përse i përket të marri një leje për ushtrimin e veprimtarisë stacion plazhi. Nga dijeninë tonë, nga informacionet tona nuk kemi pasur të paktën deri sot nuk kemi pasur që hotele që janë në qendër të Durrësit të paktën të kenë një largësi prej 3 – 4 km të kenë marrë një stacion plazhi, por siç e thamë edhe më sipër, duke qenë se VKM-ja nuk përcakton një kriter largësie, nuk është element kyç që mund të bëjë pengesë që një hotel i qytetit të Durrësit të marri një stacion plazhi. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti nënkryetar.

Kalojmë votim.

Ju lutem. Po Muka.

Ardian Muka: Më falni që ju drejtova me specialistë, nuk e dija që ishit një nga nënkryetarët. Gjithsesi problematika qëndron që me atë çfarë ju na jepni si informacion, pra zgjedhja që po bëhet natyrisht kundrejt një VKM-je që ka dalë është që, nuk kemi një studim fizibiliteti, meqënëse ky është viti i parë që aplikohet kështu. Nuk kemi ne si bashki akoma një database që sa hotele do aplikojnë dhe automatikisht neve të gjithë si këshilltarë këtu duhet të na bëjë merak që sa do jenë të ardhurat që do na hyjnë në bashki për këtë verë, pra për vitin 2025 dhe kur të mbledhemi këtu që të bëjmë raportin ku duhet ta drejtojmë gishtin për ndofta gabimin që jemi duke bërë. Kjo është e rëndësishme. Unë e di se ku është gabimi. Gabimi qëndron në VKM, sepse VKM-në nuk mund ta bëjë Tirana për interesat të vogla ndofta që ato mund të kenë. Ndërkohë që interesat e qytetit i caktojmë ne. I cakton, i cakton edhe ky këshill, i cakton Bashkia dhe tek e fundit i caktojnë qytetarët. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Kalojmë në votim. Ju lutem.

Jo, po nuk e ke thërritur kështu që

Patjetër. Po zoti Burgia, kërkoje të lutem.

Dritan Burgija: Shiko, duhet të kemi parasysh meqë janë dhe specialistë të fushës që janë marrë me këtë punë nga Bashkia. Pavarësisht që miratimin e bëjnë institucione të tjera, Bashkia i çon, i çon parcelat apo jo? Dhe duhet pasur parasysh që jo vetëm turistët që flejnë nëpër hotel e bëjnë plazhin, janë dhe pjesë tjetër e popullsisë që bëjnë plazh ditor dhe këtu unë flas si qytetar, flas edhe si aplikant për stacion plazhi. Tani duhet pas parasysh kur bëni materialin, po se jam në konflikt interesi, po dëgjo, nuk votoj unë te ajo pjesa, por gjërat, gjërat që i ndiejmë kurriz duhet me i thënë. Tani duhet pas parasysh që duhet duhen përjashtuar zona të caktuar, që janë zona të pabanume, por që shërbejnë si stacione plazhi, përjashtohen nga rregulli nga VKM-ja.

Tani unë po nuk e thashë këtë sot këtu do më thonë pse s'e thatë apo jo Land? Ju falenderoj.

Jam një çik me vonesë Lando. Po tashi ecën koha.

Denisa Luarasi: Atëherë kalojmë votim.

Kush është pro pikës 8 të rendit të ditës?

Dorina Milja: Rakipi iku. Ka iku.
Hajde pra.

Denisa Luarasi: Pro?

Kundër? ...

Abstenim?

Okej atëherë me 35 pro.

Me 35 vota miratohet pika 8 e rendit të ditës.

- Jepet fjala për projektvendimin e **pikës 9**, Komisionit të Mandateve zonjës Ana Dhamo.

Ana Dhamo: Faleminderit zonja kryetare.

Komisioni i Mandateve pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga Sekretariati i Këshillit me vota unanime vendosi ta kalojë për votim në mbledhjen e sotme të Këshillit Bashkiak. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Komente? Në fakt doja....

Po, zoti Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Në fakt komentin do e bëj për të dy pikat.

Dëshiroj të paktën në emër të grupit tonë t'i përsërisim edhe zotin Ani Dymishi edhe zonjën Manjola Luku për kontributin që kanë dhënë gjatë gjithë kësaj periudhe në Këshillin Bashkiak dhe kam shpresë që frymën pozitive që ka mbizotëruar në Këshillin Bashkiak me ato oshilacionet e veta kundrejt pozicioneve politike që mbajnë ta pasqyrojnë më së miri edhe në Kuvendin e Shqipërisë. Është kënaqësi për ne që nga ky këshill dy përfaqësues shkojnë në Kuvendin e Shqipërisë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Ju urojmë shumë suksese zotit Ani Dymishi edhe zonjës Luku tek pika e 9. Patjetër.

Atëherë kalojmë votim. Kush është pro?

35. Okej.

Kundër?.....

Abstenim ?.....

Me 35 vota pro miratohet.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 10**, Komisionit të Mandateve zonjës Ana Dhamo.

Ana Dhamo: Edhe për pikën 10, Komisioni i Mandateve me unanimitet votash propozon të kalojmë për votim në mbledhjen e sotme. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Dhamo.

I urojmë shumë suksese edhe zonjës Manjola Luku.

Atëherë kalojmë votim.

Kush është pro?

Kundër?

Abstenim..... Jo.

Me 35 vota pro miratohet dhe pika e 10 e rendit i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 11** Komisionit Rregullores dhe Çështjes Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Bashkë të dy jemi, bashkë.

Atëherë dhe për pikën 11, komisioni ynë me shumicë votash e miraton dhe propozon sot Këshillit për votim. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Kulturës, Arsimit, Sporteve, Komunitete Fetare dhe Titujve të Nderit, zonja Nurie Gjoni.

Nurie Gjoni: Përshëndetje!

Edhe komisioni ynë ra dakort për ta kaluar në votim.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Gjoni.

Komente, pyetje kemi?

Kalojmë në votim.

Kush është pro pikës 11 rendit ditës?

Kundër?

Abstenim?

Me 34 vota pro miratohet pika 11 e rendit ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 12** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: E fundit për sot kryetare ta mbyllim me sukses.

Atëherë dhe pikën 12. Komisioni ynë propozon sot që të miratohet në këshill.

Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës zonja Jonada Mamo.

Jonada Mamo: Edhe komisioni jonë propozon ta kaloj për votim.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Mamo.

Kemi komente?

Atëherë zoti Burgia po

Dritan Burgija: Ne jemi shprehur edhe mbledhjen tjetër kundër kësaj pike, për thjesht në shërbim të mjedisit e kemi atë sikletin tonë pasi do shpyllëzohet një sipërfaqe goxha e madhe atje me pisha që janë dhjetra vjeçare, pamvarësisht faktit që subjekti merr përsipër të pyllëzojë diku tjetër, por nuk është e njëjta gjë. Domethënë zëvendësimi nuk është e njëjta gjë. Sa i përket ndryshimeve që keni sjellë, unë s'kuptoj ndoshta se kam lexu mirë.

Denisa Luarasi: Duhet të cilësohej sipërfaqja tek vendimi. Sipërfaqja është vetëm.

Dritan Burgjia: Sipërfaqja okej.
Jemi kundër kësaj domethënë dhe e shprehim sërish.

Denisa Luarasi: Faleminderit.
Atëhere e hedhim votim.
Kush është pro pikës 12?

Dorina Milja : 29

Denisa Luarasi: Kundër?.....

Dorina Milja : 5

Denisa Luarasi: Abstenim?

Me 29 vota pro miratohet dhe pika e 12 e rendit të ditës.

Nuk kemi kërkesa për diskutim.

Ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe angazhimin tuaj.

Kërkoj nga zonjat 10 minuta nga koha. E dimë që u zgjatëm, por vetëm zonjat.

Klea si kryetare e Aleancës ka diçka për ta komunikuar.

Ky proçesverbal mbyllet me nr. rendor 28 (njëzetë e tetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga drejtuesi i senacës, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i proçesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Drejtues i senacës (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) :	DENISA LUARASI
Sekretar i Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:	EDLIRA DEVOLLI
Këshilltar (Kr. Grupi) :	FLUTURA KASA
Këshilltar (Kr. Grupi) :	JONUZ MYSHKETA